



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KE.nr.104/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit Republika e Kosovës, Qeveria - Ministria e Infrastrukturës, të cilin e përfaqëson Avokatura Shtetërore, kundër të paditurit Kompania “A...” SH.P.K., me seli në ... - Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.F. , me objekt kontesti kompensim dëmi, në seancën përgatitore të mbajtur me datë 17.01.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET e tërhequr padia me numër KE.nr.104/22 (C.nr.1470/17) e datës 09.06.2017 e paditësit Republika e Kosovës, Qeveria - Ministria e Infrastrukturës, kundër paditurit Kompania “A...” SH.P.K., me objekt kontesti kompensim dëmi.
- II. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësi Republika e Kosovës, Qeveria - Ministria e Infrastrukturës, me datën 09.06.2017, ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për kompensim dëmi, me vlerë kontesti 28,429.16 €, kundër të paditurit Kompania “A...” SH.P.K.

Gjykata me datë 17.01.2023 ka caktuar seancë përgatitore, në të cilën nuk ka qenë i pranishëm përfaqësuesi i palës paditëse nga Avokatura Shtetërore, ndërsa ka qenë e pranishme vetëm përfaqësuesja e palës së paditur Kompania “A...” SH.P.K., E.F. .

Nga fletëkthesa që gjendet në shkresat e lëndës rezulton se përfaqësuesit të palës paditëse-Avokatura Shtetërore, thirrja për këtë seancë i është dorëzuar në mënyrë të rregullt 15.12.2022.

Sipas parashtrës së datës 13.01.2023, përfaqësuesi i palës paditëse avokati shtetëror Naim Krasniqi, ka paraqitur kërkesë për shtyrjen e seancës për shkak se i njëjti është në pushim vjetor nga data 16.01.2023 deri më datë 20.01.2023.

Përfaqësuesja e palës së paditur në seancën ka deklaruar se pala paditëse edhe në paditë e ushtruara gjatë vitit 2014, 2015 dhe 2016, asnjëherë nuk kanë prezentuar në seanca gjyqësore dhe as në seancën e datës 17.01.2013, dhe i ka propozuar gjykatës që bazuar në nenin 409.1 të LPK-së, të konsideroj padinë e paditësit si të tërhequr, pasi që i njëjti është ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata pas vlerësimit me kujdes të parashtrës së datës 13.01.2023, të paraqitur nga avokati shtetëror Naim Krasniqi, gjeti se kërkesa për shtyrjen e seancës nuk është e bazuar në asnjërin nga shkaqet e përcaktuara me nenin 438 të LPK-së.

Gjykata vlerëson se kërkesa për shtyrjen e seancës është e pabazuar edhe për faktin se kërkesës nuk i është bashkëngjitur asnjë dëshmi se i njëjti gjendet në pushim vjetor, e po ashtu nuk është dorëzuar asnjë dëshmi se në rastin konkret asnjë nga avokatët tjerë shtetëror nuk kanë pasur mundësi të marrin pjesë në këtë seancë.

Po ashtu duke marrë parasysh faktin se avokati shtetëror kryen detyrat në kuadër të Avokaturës Shtetërore, si organ qendror i administratës në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka një numër të caktuar të avokatëve shtetëror, pushimi vjetor i njërit prej tyre nuk paraqet bazë për mos prezencë në seanca dhe as bazë për shtyrjen e tyre.

Andaj nisur nga fakti se përfaqësuesi i palës paditëse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt për këtë seancë, i njëjti nuk ka marr pjesë në seancë, si dhe shkaqet në të cilat është mbështetur kërkesa e tij, nuk paraqesin bazë për shtyrjen e seancës, si dhe të njëjtat nuk janë të mjaftueshme për të arsyetuar mungesën e tij, gjykata duke u bazuar në nenin 409 paragrafin 1 të LPK-së, më të cilin përcaktohet se: *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të*

mbahet”, ka marr aktvendim me të cilin e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit Republika e Kosovës, Qeveria - Ministria e Infrastrukturës, kundër të paditurit Kompania “A...” SH.P.K., Fushë Kosovë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 409 par.1 dhe 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.104/22, datë 17.01.2023

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.